

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detajet - Arkitekti Olsi Eftimi ka dhënë deklarime në SPAK lidhur me hetimet për dosjen 'Balluku'
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/917132/arkitekti-olsi-eftimi-ka-dhene-deklarime-ne-spak-lidhur-me-hetimet-per-dosjen-balluku/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 15:33:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:11:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7a17bad9cf3eb3465078c56a0ac9af059c246d51d8d40a71ca5545eeca66aa9
TEKSTI	206a4384074118446d62f5912ce96aae25443118892e22fcbb236eec9d8f7388
PAMJA	7d7a984c8dfc667b0bd4f02c9a7b1fcbdf68473aca9675d3198ce5eb071e5dfb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2b70c64ed38841f33bf30ded70f943268b4260cde121e78634e8abfb5caf0f3c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2b70c64ed38841f33bf30ded70f943268b4260cde121e78634e8abfb5caf0f3c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ÇIM PEĐA**
Tradhtia që s'e panë tu ardhë**NDRIÇIM KULLA**
Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës

LAJMI I FUNDIT

TASK FORCE/ Vendimi, 81 vite burg për ish krerët e UÇK

më të lexuarat

'Rama jepe dorëheqjen!' Tiranë zgjohet me protesta, policia shoqëron 7 protestues

Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve

Përplasja me armë/ Alket Rizai në kërkim, sot duhej të paraqitej në burg pasi kishte marrë leje

Si u rrëzua banda shqiptare e trafikantëve nga imazhi i një luani i krijuar me IA

Trafikanti shqiptar i shpëton burgut: Partnerja ka depresion dhe dhimbje kronike

Alarmi për bombë në një shkollë në Tiranë rezultoi fals, arrestohet një person/ EMRI

**Arkitekti Olsi Eftimi ka dhënë deklaratime në SPAK lidhur me hetimet për dosjen 'Balluku'**

17:11, 16/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Ka dalë nga SPAK pas disa orësh, Olsi Eftimi, arkitekti i studios "Atelier 4". Ai u mor në pyetje në lidhje me vilën që SPAK thotë se i përket Belinda Ballukut në Green Coast, por që fshihej nën emrin e Igli Tares. Një nga provat për pronësinë reale të vilës është emaili që Eftimi i dërgonte Ballukut.

Në këtë komunikim, arkitekti i propozonte Ballukut zgjidhje estetike për një vilë në Palasë, duke theksuar se projekti ishte rishikuar me idenë që përdoruesit e vilës të ndjeheshin "të iltuar".

Projekt-ideja përfshinte një pishinë "infinity", gjelbërim kacavjerrës, një tavolinë ngrënie në të njëjtin nivel me ujin dhe një pistë vrapimi pranë pishinës për seanca të gjata me pamje nga deti. Për të theksuar luksin e pakompromis, arkitekti sugjeronte vendosjen e dy vaskave hidromasazhi të frymëzuara nga hoteli i famshëm "Rocabella" në Santorini si dhe veshjen e terracës dhe pishinës me dru "teak" për një ndjesi të ngrohtë të ngjashme me atë të një jahti.

"Kemi idenë që edhe nëse një ditë vendos ta japësh me qira, përdoruesit të mund të ndihen 'të iltuar' njësoj si në hotel," i shkruante ai Ballukut. "Shihe si alternativë kur të përfundojmë edhe renderat dhe nëse s'të ngjit, kthehemi te mermerët blu," shtonte ai.

Sipas hetimeve të SPAK, këto detaje ekskluzive luksi nuk ishin tek atë blerësi çfarëdo, por kërkesat e drejtpërdrejta të ministres së atëhershme të Infrastrukturës, Belinda Balluku për një vilë në rivierën shqiptare që dyshohet se është përfituar përmes korrupsionit.

Sipas një vendimi të Gjykatës së Posaçme për masën e sekuestros, shpenzimet për këto kërkesa të arkitekturës variojnë nga rreth 290 deri në 410 mijë euro dhe u paguan nga kompania "Alko Impex General Construction", e cila po shpërblehej në të njëjtën kohë me një tender prej 2.2 miliardë lekësh [rreth 23.9 milionë euro]

për Unazën e Madhe të Tiranës.

Prokuroria e Posaçme pretendon se vila në Palasë është produkt i korrupsionit dhe i pastrimit të parave.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Vijojnë kontrollet në burgje, sekuestrohet një tjetër telefon në qelinë e të dënuarit në Durrës



Futi paisje e 'Botox' kontrabandë, 285 mln lekë të pa paguara! Merret i pandehur biznesmeni Dritan Gremi



Ilir Meta kërkoi pezullimin e afateve të paraburgimit, GJKKO shtyn vendimin!

Roskovec/ Daja i Zegjine Çaushtit plagosi me çekiç ish-vjehrrin e tij

Arrestohet në flagrancë një efektiv policie, dy të tjerë hetohen në gjendje të lirë

I dhunojnë dhe arrestojnë/ Policia prangos 12 protestues se thirrën: Rama jepe dorëheqjen

TË NGJASHME



Një ditë pas dënimit nga GJKKO, Aldo Avdyli merr dënim të dytë me 3 vite burgim për pistoletën 'Bereta'



Kapet në makinë me 6 emigrantë nga Sudani, 700 euro 'bileta' për në Tiranë! Arrestohet 23 vjeçari



Vrasja e Kevin Muharremi/ Shtohen telashet ligjore për Renato Xyken, akuzohet edhe për plagosje



Arratisja e radhës e Alket Rizait/ Kishte përfutur 16 leje nga burgu, nis mega-operacioni i kërkimit



Shkatërrohet banda e shqiptarëve, dyshohet për të paktën 40 grabitje në banesa



18 kg drogë, në pranga trafikanti shqiptar në Vjenë



Aksident në aksin rrugor Lezhë-Shkodër, plagosen tre persona

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.